



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 21.12.2020

RAPORT

RAPORT MBI SHQYRTIMIN E KANDIDATURAVE PËR INSPEKTOR TË PËRGJITHSHËM TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 21 dhjetor 2020, organizoi seancën dëgjimore për shqyrtimin e kandidaturave të vetëofruara për pozicionin vakant të Inspektorit të Përgjithshëm Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit.

Bazuar në nenin 11, pika 3, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, Komisioni në mbledhjen e datës 20 nëntor 2020, evidentoi vakancën e krijuar për pozicionin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, duke pasur parasysh detyrimin ligjor që vakanca duhet të shpallet tre muaj përpara përfundimit të mandatit të z. Shkëlqim Ganaj.

Komisioni në përfundim të mbledhjes miratoi vendimin e tij nr. 4/2020, ku vendosi menjëherë shpalljen e vakancës së krijuar dhe ftoi për paraqitjen e kandidaturave për Inspektor të Përgjithshëm, individët që përcakton ligji.

Në zbatim të vendimit të sipërpërmendur, shërbimet e Kuvendit publikuan në faqen zyrtare të institucionit njoftimin përkatës si dhe kushtet e kriteret që duhet të plotësonin kandidatët e propozuar, si dhe përcaktuan datën **10 dhjetor 2020** si afatin përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit të secilit kandidat.

Në përfundim të afatit të dorëzimit të dokumentacionit, rezultoi se depozituan dokumentacion kandidaturat; znj. Dhimitrula Spiro, znj. Helena Papa, znj. Evgjëni Bashari, znj. Evis Fico, znj. Leterije Lleshi dhe z. Eridian Salianji.

Për këtë proces depozitoi dokumentacion edhe z. Sali Shehu, por dokumentacioni nuk mund të administrohej pasi është depozituar në Kuvend në datën 18.12.2020 protokolluar me nr. 3173 të Kuvendit, 8 ditë pas afatit të përcaktuar sipas vendimit të Komisionit në shpalljen e publikuar në faqen e Kuvendit.

Sipas përcaktimeve ligjore të nenit 11, pika të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar lista e kandidatëve i kalon komisionit të përhershëm të Kuvendit që mbulon çështjet ligjore për të verifikuar përmbushjen e kriterëve dhe kushteve përkatëse.

Komisioni për vlerësimin e kandidaturave, mori në konsideratë dispozitat e neneve 12 dhe 13, të ligjit të sipërpërmendur, individi që kandidon për vendin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, duhet të plotësojë kushtet:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik ose ekonomik në profilin financë, Diplomë e Nivelit të Dytë;
- Të ketë vjetërsi në profesion, si jurist ose ekonomist financiar, jo më pak se 15 vjet;
- Të mos jetë dënua penalisht me vendim të formës së prerë;
- Të mos jetë anëtarë të partive politike, deputet, ministër, zëvendësministër, pjesëtar në strukturat e Policisë së Shtetit, Forcat e Armatosura dhe Shërbimin Informativ Shtetëror.

Kandidati që përmbush kushtet ligjore, të parashikuara më sipër, zgjidhet Inspektor i Përgjithshëm në bazë të këtyre kriterëve objektive:

- vjetërsisë në profesion;
- përvojës së veçantë profesionale në fushën e së drejtës penale/administrative ose veprimtarinë audituese;
- ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë;
- gëzimit të integritetit të lartë moral, ku përfshihen, ndër të tjera, transparenca e plotë dhe e dokumentuar e të gjitha të ardhurave dhe aseteve, pagimi i të gjitha detyrimeve tatimore, si dhe informacionet zyrtare, të marra nga institucione të tjera publike, përfshirë dhe informacionet konfidenciale.

Gjithashtu, funksioni i Inspektorit të Përgjithshëm është i papajtuësëm me:

- çdo funksion tjetër publik;
- çdo veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies;
- anëtarësimin në partitë politike dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë e tyre;

Gjatë seancës dëgjimore, kandidaturat u prezantuan dhe i'u përgjigjën pyetjeve të anëtarëve të Komisionit. Anëtarët vlerësuan të gjitha kandidaturat.

Gjatë zhvillimit të dëgjësive, kandidatët shpjeguan arsyet e kandidimit të lidhura me përvojën profesionale në fushat e luftës ndaj korrupsionit, kontrollit të pasurive, auditimit financiar të funksionarëve publikë, etj.

Në zbatim të dispozitës të nenit 11, pika 6 , e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, sipas të cilës Komisioni përzgjedh të paktën dy kandidatë të cilët i kalojnë Kuvendit për votim, pas dëgjësës publike dhe votimit nominalisht për secilën kandidaturë, u vendos me 15 vota pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm, për kandidaten Znj. Evgjëni Bashari dhe 14 vota pro dhe 1 abstenim për kandidaten znj. Helena Papa, si dy kandidaturat e përzgjedhura nga Komisioni i Ligjeve për t’iu përcjellë për votim seancës plenare.

Kuvendi zgjedh Inspektorin e Përgjithshëm me 3/5 e anëtarëve të tij në votimin e parë. Në rast se kjo shumicë votash nuk arrihet, Kuvendi zhvillon votimin e dytë jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi pa sukses i votimit të parë. Në votimin e dytë, Kuvendi zgjedh Inspektorin e Përgjithshëm me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

Bashkëlidhur këtij raporti, projektvendimi përkatës.

RELATOR

Klotilda BUSHKA

Ediola BRAHA

KRYETAR

Ulsi MANJA

